



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 26.01.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIMIN E AKTIVITETEVE TË KRYETARËVE TË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE TË KOMUNËS SË LIPJANIT

- I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 28.000.00 € (njëzet e tetë mijë euro), për subvencionimin e aktiviteteve të 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit me nga 500 € (pesëqind euro) për secilin kryetar të këshillit të fshatit apo lagjes urbane.
- II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të subvencionimit përkatësisht ofrimit të mbështetjes financiare për aktivitetet e zhvilluara të kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane.
- III. Mjetet financiare për ekzekutimin e këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2024 , fondi burimor :21/613/16003/200/00000/0111 në xhirollogarinë bankare personale të secilit kryetar/e të këshillit të fshatit apo lagjes urbane.
- IV. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është lista e kryetarëve të këshillave të fshatrave – lagjeve urbane.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 15-400/01-5670

Lipjan, më 26.01.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

